

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"E&M MANIFACTORY" SHPK

Sot me daten 22/11/2023 (dymijë e njëzet e tre), ne ortaket themelues :

1 **Z. ERLIN HUSHI**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 03 Gusht 1988, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. I80803008E.

2 **Z. MASSIMO MORETTO** ,shtetas Italian , i datëlindjes 19 Janar 1970, lindur në Itali, dhe banues në Itali, disponues i letërnjoftimit (kartë identiteti), me Nr. YC0491438.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " E&M MANIFACTORY" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " E&M MANIFACTORY" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Kameras,Durrës,Ndërtesë me nr pasurie 38/37/ND, , zona kadastrale 2065,vol.6,fq 113.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shërbime qepje për të gjitha llojet e veshjeve,këpucëve,cantave,portofolove dhe cdo lloj tekstili.Fason,nënkontraktor fasoni.Import-eksport të cdo lloj tekstili.Komisioner për aktivitetin fason.

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë " E&M MANIFACTORY" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) secila.



Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:

1. ERLIN HUSHI zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.

2. MASSIMO MORETTO, zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.

NENI 5

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administratori i shoqërisë do të jetë

1- Z. Erlin Hushi, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9



LIKUJDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10

MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

"E&M MANIFACTORY" SH.P.K

ERLIN HUSHI

MASSIMO MORETTO

Erlin Hushi


MORETTO MASSIMO
